

RELACION

MBI

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9047, DATË 10.07.2003 “PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji nr. 9047 është miratuar përpara 17 vitesh dhe ka përcaktuar rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet e organeve shtetërore dhe subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak. Ai është hartuar në vitin 2003 dhe objekt i tij është shërbimi i detyrueshëm ushtarak si ai aktiv dhe ai në rezervë. Nga viti 2003 kanë ndodhur shumë ndryshime si në FA ashtu edhe në shoqërinë dhe shtetin shqiptar.

Me antëratësimin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kanë pësuar ndryshime të mëdha në të gjitha drejtimet. Një nga ndryshimet thelbësore ka qenë kalimi nga një shërbim ushtarak i detyrueshëm në një shërbim me baza vullnetare.

Forcat e Armatosura do të kenë një komponent rezervë jo më shumë se 25% të komponentit aktiv (2100 veta), referuar VKM Nr. 628, datë 25.9.2019 “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu ligji i shërbimit ushtarak nuk është në harmoni me ligjin 59/2014 “Për karrierën ushtarake në FA” i ndryshuar.

Prej vitit 2010, shërbimi në Forcat e Armatosura është mbi baza vullnetare (Forca e Armatosur është _profesioniste) dhe ligji konsiderohet i “konservuar”. Ndërkohë disa përcaktime të veçanta në këtë ligj është e nevojshme të harmonizohen me ligje të tjera dhe disa elementë duhet të reflektojnë ndryshimet strukturore të ndodhura në FA.

Ndryshimi kryesor në këtë ligj ka të bëjë me harmonizimin e nenit 9 të tij me nenin 14 të ligjit nr. 59/2014, lidhur me moshën e kryerjes së shërbimit ushtarak në rezervë nga shtetasit.

Ndryshimet të tjera janë ato që kanë të bëjnë me strukturën që “gjeneron” komisionin mjeksor të kontrollit të aftësive fizike, reflektimin e njësive të qeverisjes vendore në përputhje me ligjin respektiv, ruajtja e vendit të punës nga subjektet private për komponentin rezervist kur thirret në raste emergjencash dhe situatash të ndryshme etj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1121, datë 30.12.2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

“Ligji nr. 9047, datë 10.07.2003, “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka pësuar 2 (dy) ndryshime deri tani. Në vitin 2006 me Ligjin nr. 9487, datë 6.3.2006, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH” dhe në vitin 2008 me Ligjin nr.9999, datë 25.9.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në RSH, të ndryshuar”.

Duke filluar nga viti 2010, ky ligj në veçanti për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv filloi të aplikohet jo më mbi bazën e detyrimit, por mbi baza vullnetare, fillimisht si ushtar me pagesë ndërsa sot me emërtim “ushtar/detar aktiv”. Ndërsa për shërbimin ushtarak në rezervë për plotësimin e strukturave të Forcave të Armatosura, më gjithë përpjekjet e bëra për ngritjen e strukturave e funksionimin e saj sipas eksperiencës së vendeve të NATO-s, akoma nuk është bërë organizimi dhe përdorimi i komponentit në rezervë.

Ky projektligj është i domosdoshëm pasi ligji në fuqi nuk ndihmon në organizimin e një Force rezerviste sipas standardeve të NATO-s. Edhe ato përpjekje që janë bërë deri tani nga ana e SHP dhe strukturave të varësisë i referohen kryesisht eksperiencës së kaluar. Nga hapat e hedhur deri tani mendojmë se ka paqartësi për organizimin dhe përdorimin e komponentit në rezervë.

Për një menaxhim sa më të mirë të ushtarakëve aktiv që dalin në rezervë mendojmë se duhet bërë disa ndryshime në nenin 9, të ligjit 9047, pa pritur rishikimin në tërësi të tij.

Sugjerojmë të ndryshohet neni 9, i ligjit në fuqi pasi nuk është në harmoni me nenin 25, dhe nenin 14, të ligjit 59/2014. “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Mosha e daljes në rezervë sipas nenit 14, sipas kategorive të ushtarakëve dhe gradave, është më e madhe se sa mosha që ka përcaktuar neni 9, i ligjit 9047. Si rrjedhojë shumica e ushtarakëve që largohen nga shërbimi aktiv dalin në lirim. Për të krijuar mundësinë që ushtarakët që dalin nga shërbimi aktiv të mund të shërbejnë disa vite në shërbimin në rezervë, duhet ndryshuar pika 3 e nenit 9 (mosha e shërbimit në rezervë).

Gjithashtu, ligji 9047 ka përcaktuar kriteret moshe të ndryshme për meshkujt dhe femrat, për shërbimin në rezervë, e cila nuk është e drejtë dhe as në harmoni me ligjin 59/2014. “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji 59/2014. “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nuk bën dallime midis personelit ushtarak meshkuj dhe atyre femra për daljen në rezervë/lirim dhe për këtë arsye sugjerojmë që ky përcaktim për femrat në ligjin për rezervistët të hiqet.

Me këto ndryshime rritet moshë e shërbimit në rezervë për nënoficerët dhe oficerët. Ky ndryshim është në harmoni me ligjin 59/2014 dhe krijon mundësi që ushtarakët pas ndërprerjes së shërbimit aktiv të shërbejnë disa vite në shërbimin në rezervë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji nr. 9047, datë 10.07.2003, “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është ligj në fuqi që nga viti 2003, i cili përcakton rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak.

Duke filluar nga viti 2010, ky ligj në veçanti për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv filloi të aplikohet jo më mbi bazën e detyrimit, por, mbi baza vullnetare, fillimisht si ushtar me pagesë ndërsa sot me emërtim “ushtar/detar aktiv”. Ndërsa për shërbimin ushtarak në rezervë për plotësimin e strukturave të Forcave të Armatosura, më gjithë përpjekjet e bëra për ngritjen e strukturave e funksionimin e saj sipas eksperiencës së vendeve të NATO-s, akoma nuk është bërë organizimi dhe përdorimi i komponentit në rezervë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 10.2.2016 “Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme”, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 628 datë 25.09.2019 “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë” (RSM), kanë përcaktuar detyrime për forcën/komponentin rezervë.

Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes (VKM nr. 628 datë 25.09.2019) ka përcaktuar se “Niveli i ambicies së FARSH-ve është i ndërthurur me kapacitetet e NATO-s, të cilat plotësojnë atë pjesë të kapaciteteve Operacionale që vendi ynë nuk ka burime të mjaftueshme dhe mundësi për t’i zhvilluar”.

Gjithashtu në fund të pikës 4.4. të kreut IV “Sistemi i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë”, të VKM nr. 628 datë 25.09.2019, përcaktohet se: “*Numri i personelit të FARSH-ve do të jetë në vitin 2020: 8500 forca aktive dhe 2100 forca rezerviste (25% të forcave aktive)*”.

Për organizimin dhe zhvillimin e strukturës/komponentit në rezervë në FA në kushtet aktuale, është i nevojshëm rishikimi në tërësi i ligjit nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili nuk përputhet harmonikisht edhe me ligjin nr. 59/2014, datë 12.06.2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Deri në rregullimet në tërësi të ligjit nr. 9047, datë 10.07.2003 “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe për sigurimin e kontingjenteve cilësore për aktivizimin e ushtarakëve aktiv pas mbylljes së karrierës ushtarake si aktiv në kontingjent rezervë, propozojmë **të bëhet ndryshimi i pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 9047, datë 10.07.2003** “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

3. Shërbimi ushtarak në rezervë kryhet nga shtetasit e moshës:

- a) deri 45 vjeç për ushtarët;*
- b) deri 55 vjeç për nënoficerët;*
- c) deri 60 vjeç për oficerët;*

Me rritjen e moshës në rezervë në ligjin e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, thithen më shumë kontingjente cilësore për komponentin rezervist, si dhe ka një përputhshmëri edhe me ligjin nr. 59/2014, datë 12.06.2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili është në proces të ndryshimeve.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Projektligji do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi